



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:066894

Datë: 04.07.2022

Numri i dokumentit: 03197816

P.Nr.219/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me zyrtare ligjore Atdhetare Bashota Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurve: M.B. dhe R.B., për shkak të veprës penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.1, të Kodit nr. 06/L/074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.Nr. 25/2021, (2022:066894), të datës 05.04.2022, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit ND.nr. 82/2022, të datës 28.06.2022, të lidhur në mes të pandehurit R.B. dhe të dëmtuarit Q.B., jashtë seancës, e në mbështetje të nenit 358, par.1, pika 1.3, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP) dhe nenit 2, par.2, nenit 8 dhe nenit 15, par.1, të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), me datë 04.07.2022, gjykata nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

1. Hedhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.Nr. 25/2021, (2022:066894), e datës 05.04.2022, dhe, pushohet procedura penale ndaj të pandehurit: M.B., nga i ati M., e ëma Sh., e vajzërisë H., “data e lindjes”..., në komuna e Mitrovicës, me adresë të fundit, Mitrovicë, me nr. personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.1, të KPRK-së.
2. APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr. 82/2022, e datës 28.06.2022 e lidhur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në mes të palëve të pandehurit R.B. dhe të dëmtuarit Q.B..
3. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.Nr. 25/2021, (2022:066894), e datës 05.04.2022, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: R.B., nga i ati M., e ëma H., e vajzërisë B., “data e lindjes”..., në K.Mitrovicë, me nr. personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës për veprën penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.1, të KPRK-së.
4. Në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 04.07.2022 e njëjta e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.
5. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet e gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP.II.Nr. 25/2021, (2022:066894), të datës 05.04.2022, kundër të pandehurit R.B., për shkak të dyshimit për veprën penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.1, të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, datë 17.06.2022 prokurori i shtetit është tërheq nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit M.B., për shkak se i njëjti ka vdekur. Në këtë seancë, i akuzuari R.B. i ka propozuar gjykatës brenda mundësive ligjore që kjo çështje të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit, pasi është e gatshme të arrij marrëveshje eventuale. Prokurori nuk e ka kundërshtuar, andaj gjykata me aktvendim procedural e ka dërguar këtë lëndë në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datën 28.06.2022, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është arritur Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.Nr. 82/2022, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit R.B. dhe të dëmtuarit Q.B., të cilën marrëveshje gjykata e ka pranuar më datën e njëjtë.

Andaj, Gjykata duke vepruar komfor dispozitave të nenit 2, par.2 dhe nenit 15, par.1, të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15, par.1, të Ligjit për Ndërmjetësim, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve e duke u bazuar në nenin 358, par.1, pika 1.3, të KPP-së, vendosi që të hedhë akuzën dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit.

Komfor nenit 15, par.1, të Ligjit për Ndërmjetësim në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 04.07.2022, do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 454, par.1, të KPP-së, pasi që është pushuar procedura penale, ndërsa që i pandehuri i ka paguar vetë shpenzimet e ndërmjetësimit në atë procedurë.

Nga sa u tha më lartë dhe komfor nenit 358, par.1, pika 1.3, të KPP-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15, par.1, të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

**Departamenti i Përgjithshëm
P.Nr. 219/2022, datë 04.07.2022
2022:066894, 04.07.2022**

Gjyqtari

Rrahman H. BEQIRI

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.